

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË "YEMEN RESTORANT" SH.P.K.**

Sot, me datë 26/04/2018,

- **Mohammed Ali Mohammed Obadi**, i biri i Ali, shtetas Jemenas, lindur më 02/05/1983, në Jemen, banues në Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga "Ali Demi", Pallati 4, Shkalla 3, Kati përdhe, mbajtës i dokumentit të identifikimit Pashaportë me nr. 06332750, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
- **Adnan Haidarah Mohammed Mohsen**, i biri i Haidarah, shtetas Jemenas, lindur më 07/11/1990, në Abian - Yem dhe banues në UAE Dubai, mbajtës i dokumentit të identifikimit Pashaportë me nr. 05135060, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
- **Adel Thabit Ahmed Thabit**, shtetas Jemenas, i biri i Thabit, lindur më 01/01/1982, në Abian - Yem dhe banues në UAE Dubai, mbajtës i dokumentit të identifikimit Pashaportë me nr. 05410890, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
- **Salah Mohammed Jubran Al - Saadi**, shtetas Jemenas, i biri i Mohammed, lindur më 19/07/1967, në Abian - Yem dhe banues në Arabi Saudite, Jeddah, mbajtës i dokumentit të identifikimit Pashaportë me nr. 06787600, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "YEMEN RESTORANT" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1
EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "YEMEN RESTORANT" Sh.p.k.

**NENI 2
SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Siri Kodra", Godinë 3 Katëshe, Kati i Parë, Nr. Pasurie 1/758, ZK 8340, Tiranë, Shqipëri.
Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

**NENI 4
OBJEKTI**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Restorant dhe Bar – Kafe.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 10.000.000 (dhjetë milion) Lekë dhe përbëhet nga 4 (katër) kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Mohammed Ali Mohammed Obadi**, zotëron 1 kuotë, me 25% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë dhe 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Adnan Haidarah Mohammed Mohsen**, zotëron 1 kuotë, me 25% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë dhe 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Adel Thabit Ahmed Thabit**, zotëron 1 kuotë, me 25% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë dhe 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Salah Mohammed Jubran Al – Saadi**, zotëron 1 kuotë, me 25% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë dhe 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicën të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË

Drejtimi i Shoqërisë kryhet nëpërmjet organeve të shoqërisë, të cilat janë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve; - Administratori/ët.

Asambleja e Përgjithshme do të jetë organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

Z. Mohammed Ali Mohammed Obadi, caktohet Administrator i shoqërisë. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ri-emërimi.

NENI 7 LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8
DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.
Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Administratorin, Z. Mohammed Ali Mohammed Obadi**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.


ORTAKËT THEMELUES

MOHAMMED ALI MOHAMMED OBADI



ADNAN HAIDARAH MOHAMMED MOHSEN

Përfaqësuar me Prokurë nga
PRANVERA HOXHA



ADEL THABIT AHMED THABIT

Përfaqësuar me Prokurë nga
PRANVERA HOXHA



SALAH MOHAMMED JUBRAN AL - SAADI

Përfaqësuar me Prokurë nga
PRANVERA HOXHA

